



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

15-04-2013

Shifra e Identifikimit	Shifra e Identifikimit	Shifra e Identifikimit	Shifra e Identifikimit
01-013/322			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 17 pika f) nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr 03/L 087. dhe nenit 76 pika 3 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2013, aprovon këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË AKSIONARËVE PËR**  
**N.P.K. "NATYRA" SH.A. VITI**

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Vendimin për formimin dhe emërimin e Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale " NATYRA" në Viti për menaxhimin e mbeturinave në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Komisioni i Aksionarëve përbëhet prej 3 anëtarëve: dy anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe një nga Ekzekutivi dhe atë:

1. Avdyl Bajrami – kryesues,
2. Bujar Ostrogllava – anëtar dhe
3. Dionita Tahiri – anëtare.

Neni 3

Komisioni Komunal i Aksionarëve për N.P.K. "NATYRA"sh.a. vepron në emër të Komunës së Vitisë dhe atë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 4


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Shërbime Publike
2. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebibi